



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 321/2010**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Rafet Haxha dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën, e Suzana Novobërdaliu, Përfaqësuese Ligjore e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK) që ka të bëjë me shkeljen e Rregullës Nr.11/2009 “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”, në seancën e mbajtur me datë 06.12.2010 mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** Ankesa si e pabazuar.

## **A R S Y E T I M**

Suzana Novobërdaliu, Përfaqësuese Ligjore e Subjektit Politik AKR dega në Prishtinë, ka parashtruar Ankesë kundër subjektit politik AAK, e cila ka bërë shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a), duke bërë Veprime të Ndalura, në Sheshin “Nëna Tereze” me ç’rast kandidati i subjektit politik AAK Shkelzen Jusaj me nr. 55 ka vendosur posterat e tij reklamues mbi posterat e kandidatit të subjektit politik AKR Avdi Mehmetaj me nr23.

Më 05 dhjetor 2010, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Suzana Novobërdaliu, Përfaqësuese Ligjore e (AKR) dega në Prishtinë, duke pretenduar se subjekti politik AAK, ka bërë shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a).

Parashtruesja e ankesës si provë ka përmendur fotot si dëshmi nga vendi i ngjarjes, të cilat nuk ia ka bashkangjitur ankesës.

**Rregulla dhe Procedurat e PZAP-it neni 3.6 pika c parasheh:**

*c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit;*

Duke i shqyrtuar ankesën e paraqitur nga pala ankuese, PZAP konsideron se ankesa në fjalë ka mungesë të provave të mjaftueshme dhe të pranueshme për t'u bindur se AAK ka mbuluar posterin e kandidatit të AKR-së, si dhe mos prezantimi i fotove si dëshmi mbështetëse për rastin në fjalë, nuk krijon mundësinë për të vërtetuar shkeljen e pretenduar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 321/2010 më datën 06.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit**

**Muhamet Rexha**

